

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Departamenti i Komunikacionit

Studimet Master



PUNIM DIPLOME

Lënda: TEKNOLOGJIA E TRANSPORTIT

Tema: “Sistemet e transportit intermodal dhe mundësia e transportit me ndihmen HUCKE-PACK”

Kandidati:

Mirvan JERLIU

Mentori:

Prof. Dr. Musli BAJRAKTARI

Prishtinë, 2017

Përmbajtja:

Hyre	4
KAPITULLI I	5
I. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I PROBLEMIT	5
I.1. Qëllimi i hulumtimit	5
I.2. Pytjet e hulumtimit dhe hipotezat	5
I.3. Metodatat teknike të hulumtimit	5
KAPITULLI II	6
II. SISTEMET E TRANSPORTIT ME TEKNOLOGJI TË AVANCUARA	6
II.1. Sistemet e transportit intermodal	7
KAPITULLI III	7
III. SISTEMET E TRANSPORTIT HUCK-PACK	7
KAPITULLI IV	7
IV. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK A	7
KAPITULLI V	8
V. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK B	8
KAPITULLI VI	8
VI. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK C	8
KAPITULLI VII	9
VII. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK D	9
KAPITULLI VIII	9
VIII. MUNDËSIA E APLIKIMIT TË TEKNOLOGJIS HUCK-PACK NË VENDIN TONË	9
I. SISTEMET E TRANSPORTIT ME TEKNOLOGJI TË AVANCUARA	10
I.1. Sistemet e transportit	13
I.1.1. Sistemi i teknologjisë në transportim	15
I.1.2. Teknologjitë e qëllimit kryesor	15
I.1.3. Përcaktimi i kriterëve për mënyrën e transportit	15
I.1.4. Treguesit e mënyrës së transportit	16
I.1.5. Teknologjitë bazë e trafikut rrugorë	16
I.1.5.1. Objektivat e teknologjive të trafikut rrugorë	17
I.2. Teknologjia e transportit hekurudhor	18
I.3. Teknologjia e transportit ujor	19
II. SISTEMET E TRANSPORTIT INTERMODAL	20

II.1. Intermodalizimi, transporti detar me kontejner	24
II.2. Intermodalizimi dhe format tjera	29
II.3. Intermodalizimi dhe sistemi i prodhimit.....	31
II.4. Kostot e transportit intermodal	31
II.4.1.Kostot e transportit me kontejner.....	32
KAPITULLI III.....	41
III. SISTEMET E TRANSPORTIT HUCK-PACK	41
III.1. Nevojat e përdorimit të teknologjisë huckepack.....	44
III.2. Zhvillimi i teknologjisë Hucke Pack.....	44
III.3. Përparsitë e Huckepack-ut.....	45
III.4. Lidhja e shteteve Evropiane përmes tuneleve	47
IV. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK A	49
KAPITULLI V	52
V. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK B	52
KAPITULLI VI.....	62
VI. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK C.....	62
VII. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK D	68
VII.I. Manipulimi me njësitë ngarkuese te teknologjia D (Teknologjia Bimodale).....	70
VII.I.1.Nocioni dhe zhvillimi I teknologjisë.....	70
VII.2. Procedurat për formimin e kompozitit Bimodal sipas sistemit „MARK V ROAD RAILER”	71
KAPITULLI VIII	74
VIII. MUNDËSIA E APLIKIMIT TË TEKNOLOGJIS HUCK-PACK NË VENDIN TONË.....	74
VIII.1. Rrjeti hekurudhor në Kosovën e ish Jugosllavisë.....	75
VIII.2. Analiza e gjëndjes ekzistuese e infrastructures.....	76
VIII.2.1.Infrastruktura dhe transporti hekurudhor	Error! Bookmark not defined.
VIII.2.2.Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore	79
VIII.3.Zhvillimi i shërbimeve të transportit hekurudhor	79
VIII.4. Propozimi	81
VIII.5. Rekomandimi.....	83
IX. PËRFUNDIMI	84
X. LITERATURA.....	85

Hyre

Qëllimi i kësaj teme është të dihet rëndësia e teknologjisë së transportit, roli i saj dhe ndikimi i saj në zhvillimin e komunikacionit dhe rritjen e sigurisë në trafik, komunikacioni si term i përgjithshëm është një dukuri mjaft e përbërë gjatë së cilës paraqiten shumë situata konfliktuoze, prandaj është e nevojshme të merren një varg masash me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve në rrugë. Ndërsa, sa i përket mënyrës së sjelljes në komunikacionin rrugor ekzistojnë ndryshime të theksuara.

Sot të gjithë jemi dëshmitarë të zhvillimit enorm të qarkullimit dhe transportit, si në planin teknik, ashtu edhe në planin teknologjik. I tërë ai zhvillim i këtyre sferave të jetës shoqërore të gjithë njerëzve gjithnjë e më shumë i drejtohet shfrytëzimit efikas dhe efektiv të resurseve të kufizuara, qoftë atyre materiale ose financiare. Për t'i shfrytëzuar maksimalisht degët e transportit ashtu që të jenë efikase dhe efektive, është e nevojshme të njëjtat të kombinohen, të shfrytëzohen anët pozitive të llojeve individuale të transportit, kurse ato negative të zvogëlohen.

Që nga paslufta e deri më sot në Kosovë është bërë shumë pak në aspektin e zhvillimit të teknologjive të transportit, si nevojë për një zhvillim me të hovshëm ekonomik, nderlidhje me vendet fqinje dhe për të siguruar një mobilitet të qëndrueshëm në kuptimin e bartjes së njerezve dhe mallrave. Duke u bazuar në pozitën gjeografike të Kosovës, me shtrirje në pjesën juglindore të Europës, si shtet kontinental dhe pjesë e Ballkanit perëndimor e kufizuar me 4 shtete, e bënë Kosovën si vend kyç në aspektin e zhvillimit të transportit dhe nderlidhjes së korridoreve rrugore (qoftë si vend transit apo si destinacion final). Duke u bazuar në Politikën e Bashkimit Evropian në zhvillimin e transportit, është vërejtur një tendencë shumë e lartë në dhenien e përparesise së zhvillimit të transportit hekurudhor dhe transportit të kombinuar, për të siguruar lëvizje shumë efikase me ndotje sa më të vogël të ambientit. Paaftësia e korridoreve rrugore dhe hekurudhore të Kosovës për të siguruar një kalim të qëndrueshëm dhe transport (BE), me kanë shtyrë që të bëjnë këtë hulumtim, në aplikimin e teknologjise së transportit intermodal në përgjithësi dhe teknologjise huckepack në veçanti.

KAPITULLI I

I. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I PROBLEMIT

Qe nga kohërat e hershme shtrohet nevoja e mbajtjes së balansit ndërmjet nevojave të njeriut si dhe mundësisë së përmbushjes së tyre. Sa më shumë që rritet popullata, aq më shumë rriten kërkesat e saj.

Këto kërkesa, sot janë rritë aq shumë sa që vështirë mund të plotësohen nëse nuk aplikohen teknologji të reja të prodhimit dhe të shpërndarjes së tyre. Për aplikimin e teknologjive të reja kërkohen investime të mëdha. Këto investime vështirë përballohen pa aplikimin e shkencës dhe teknikës. Kështu, sot po bëhen studime dhe hulumtime për avansimin e teknologjive të reja si dhe në proqeset teknologjike në mënyrë që ato të japin rezultate sa më të mira.

I.1. Qëllimi i hulumtimit

Në kuadër të punimit master me titull "*Sistemet e transportit intermodal dhe mundësia e transportit me ndihmen HUCKE-PACK*" si qëllim kyresor i këtij hulumtimi është se sa aplikohen masat dhe normat e mbrojtjes dhe sigurisë në zhvillimin e teknologjisë së transportit në Kosovë, në bazë të rregulloreve të përcaktuara me ligj dhe standardeve Kosovare të harmonizuara nga ato Evropiane, me qëllim të rautjes dhe sigurisë të zhvillimit të teknologjisë së transportit.

I.2. Pytjet e hulumtimit dhe hipotezat

Në këtë temë të Masterit planifikohet që të fitojmë rezultatet konkrete të kënaqshme për të dhën përgjigje në pytjet për:

1. Si behet planifikimi i transportit të mallrave?
2. Si bëhet përgatitja e transportit?
3. A përdoret teknologjia e transportit Huckepack në vendin tonë?
4. Rreziqet e mundshme gjatë shfrytëzimit të transportit?
5. Si behet kombinimi i mjeteve transportuese?

I.3. Metodatat teknike të hulumtimit

Për të arritur rezultate do të përdorën këto metoda:

1. Metoda direkte
2. Metoda indirekte

KAPITULLI II

II. SISTEMET E TRANSPORTIT ME TEKNOLOGJI TË AVANCUARA

Në këtë kapitull është trajtuar rëndësia e teknologjive dhe sistemeve të transportit të cilat në masë më të vogël apo më të madhe, aplikohen në realizimin e transportit ku marrin pjesë mjetet e disa degëve dhe llojeve të komunikacionit me përdorimin e njësive të njejta transportuese.

Ato me emertimin e njejtë quhen teknologji bashkohore të transportit dhe paraqesin lloje të caktuara të transportit, teknologji të reja më progresive të transportit, dhe më së tepërmi përdoren këto llojeve të teknologjive të transportit:

- I. Teknologjia e transportit unimodal -konvencional,
- II. Teknologjia e transportit modal,
- III. Teknologjia e transporti bimodal,
- IV. Teknologjia e transporti multimodal,
- V. Teknologjia e transporti integral,
- VI. Teknologjia e transporti intermodal,
- VII. Teknologjia e transporti të kombinuar.

Sistemet e transportit i karakterizon procesi prodhues i cili realizohet me automjete të destinacionit të përgjithshëm dhe automjete të destinuara për bartje të veçanta..

Në teknologjit e avansuara hynë këto sisteme transportuese:

- sistemi transportues me paleta,
- sistemi transportues me kontejner(të gjitha llojeve),
- sistemi transportues me rimorkio ose gjysëm rimorkio transportuese,
- sistemi i enëve transportuese të ndashme.

II.1. Sistemet e transportit intermodal

Teknologjia e Transporti Intermodal (*ang. Intermodal Transport*) është teknologji transportuese në të cilën, mallrat transportohen në të njëjtën njësi ngarkese duke përdorur pa ndërprerë disa degë të transportit por brenda një hapire të brendshme në të cilën paraprakisht realizohet një proces intern- i brendshëm nacional dhe pastaj procesi transportues vazhdon në më së paku ndermjet dy shteteve.

KAPITULLI III

III. SISTEMET E TRANSPORTIT HUCK-PACK

„Me termin huckepack teknologji e transportit nënkuptohet transporti i kombinuar rrugor-hekurudhor ku mjetet rrugore (kamionet, autotrenat, bashkësia e mjeteve,) ose pjeset e automjeteve (rimorkiot, gjysënrिमorkiot, enet transportuese te ndashme) ne një pjesë të rrugës transportohen me mjete transportuese te komunikacionit hekurudhor“.

KAPITULLI IV

IV. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK A

Në kuadër të teknologjisë Huckepack "A" kryesisht studiohet problemi i transportit të automjeteve të trafikut rrugor (psh., bashkësi e mjeteve, kamionë etj) me ngarkim në vagonë hekurudhore me dysheme të ulët të veçanta.

Kjo teknologji është e karakterizuar për ngarkimin e kamioneve me rimorkio apo kokë tërheqëse me gjysmë-rimorkio, të ngarkuar me ngarkesë ose bosh në vagonë hekurudhorë.

KAPITULLI V

V. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK B

Sistemi transportues me platformë teknologjia B nënkupton transportin e rimorkiove gjysmë rimorkive pa mjet tërheqës dhe shofer me mjete hekurudhore.

Ky është lloji i shërbimit të mjeteve rrugore dhe hekurudhore është një projekt i përbashkët ndërmjet transportit rrugor dhe hekurudhor, e cila është një lidhje racionale, duke bërë të mundur realizimin e transportit "derë më derë".

Në këtë mënyrë, përfitohet nga avantazhet e veçanta të hekurudhave për një transport të rregullt, të sigurtë, të shpejtë dhe ekologjikisht të përshtatshëm, duke transportuar sasi të mëdha të mallrave në distanca të gjata në konsum relativisht të ulët të energjisë, e cila është shumë e rëndësishme në shpenzimet e përbashkëta, si dhe mobilitetin e transportuesve në zbatimin e shërbimeve të transportit rrugor.

KAPITULLI VI

VI. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK C

Kjo teknologji kërkon ekzistimin e enëve të heqshme transportuese të kamionit dhe kontenjerët të cilët janë të pajisur me pajisje speciale, respektivisht pajisje për përforcimin e tyre.

Teknologjia Huckepack C (swap-body) përbëhet nga ngarkim shkarkimi i arkave të projektuara dhe të standardizuara si kontenjerët, që janë të ngarkuar vertikalisht mbi vagonë me vinça të veqant të levizshëm.

Arkat e heqshme të kamionëve ngarkohen me ngritje të vinçave të veqant ose përmes manipulatoreve dhe paraqesin hapsirën ngarkuese të mjetit rrugor-arkën që mund të largohet nga shasia e mjetit rrugor.

Shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve është njëra nga përparsitë kryesore të tyre ndërsa e meta kryesore është gjatë deponimit vendosen në këmbët adekuate që pamundësojnë deponimin në lartësi.

KAPITULLI VII

VII. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK D

Teknologjia Huck –Pack D (Teknologjia bimodale e transportit) është teknologjia specifike e transportit për të cilën është karakteristik transporti i gjysmë-rimorkiove speciale rrugore me ngarkesën sipas rrugës dhe hekurudhës.

Kjo teknologji mundëson „transformim” të gjysmë-rimorkiove rrugore, që në mënyrë klasike e transportojnë ngarkesën në komunikacionin rrugor në „vagona” ngarkues të veçantë hekurudhorë. Ky transformim i gjysmë-rimorkiove rrugore speciale në automjetet speciale tërheqëse, përkatësisht vagonët për transportimin e ngarkesës arrihet me modelet e ndryshme të automjeteve rrugore-hekurudhore që përbëhen nga shasitë e pavarura hekurudhore dy boshtore (“boggi”) dhe gjysmë-rimorkiot rrugore me instalimin e ndërtuar për përforcimin e shasive dhe kyçjes në përbërjen bimodale.

KAPITULLI VIII

VIII. MUNDËSIA E APLIKIMIT TË TEKNOLOGJIS HUCK-PACK NË VENDIN TONË

Sistemi hekurudhor ekzistues ne Kosovë është relativisht i vjetër dhe nuk përputhet me standardet Evropiane. Për zhvillimin e shtetit të ri të Kosovës dhe për aderimin sa më të shpejtë të tij në Bashkimin Europian, veç të tjerash duhet edhe një infrastrukturë e transportit me e përparuar. Ndër infrastrukturat e transportit, transporti hekurudhore është ai me efikasitet për arsye:

- Te leverdisë ekonomike,
- Te lidhjes së Kosovës me Evropën dhe Azinë,
- Te mbrojtjes së mjedisit pasi është një transport që shkakton minimumin e ndotjes.

Për të dhënë sado pak kontributin tonë në zgjidhjen e këtij problemi të rëndësishëm ekonomik, ne ndërmorëm këtë studim dhe kërkim shkencor të parë në tre aspekte:

1. Argumentimi nga ana shkencore e praktike, pse është e domosdoshme të modernizohet ky lloj transporti,
2. Si mund të modernizohet ky lloj transporti me ndërhyrjet e ndryshme në të gjithë elementët e rrjetit.
3. Cilat janë problemet tekniko-ekonomike dhe menaxheriale të modernizimit të rrjetit hekurudhor të Kosovës.

KAPITULLI I

I. SISTEMET E TRANSPORTIT ME TEKNOLOGJI TË AVANCUARA

Sot në masë më të vogël apo më të madhë, aplikohen teknologjit e ndryshme të transportit në realizimin e të cilave marrin pjesë mjetet e disa degëve dhe llojeve të komunikacionit me përdorimin e njësive të njejta transportuese. Ato me emertimin e njejtë quhen teknologji bashkohore të transportit dhe paraqesin lloje të caktuara të transportit, teknologji të reja më progresive të transportit.

Teknologjit e reja zhvillohen në mënyrë komplekse, si pjesë përbërëse e të gjitha llojeve të transportit dhe ekonomisë, që kërkon investime të reja dhe masa tekniko – organizative. Rëndësia ekologjike e zhvillimit të këtyre teknologjive në botë dhe tek ne i tejkalon kornizat e transportit dhe bëhet një nga detyrat më të rëndësishme në racionalizimin e distribuimit të mallit dhe zhvillimit të ekonomisë së gjithmbarëshme. Në mënyrë që të realizohet cila do teknologji e transportit, duhet të ndermiren disa masa, ndersa zhvillimi i kësaj teknologjie moderne duhet të kuptohet si bashkim i elementeve teknologjike, teknike, ekonomike, organizative dhe elementeve juridike të cilët determinojnë veçurit e kësaj teknologjie të manipulimit dhe transportit.

Teknologjit esencialisht e ndrojnë procesin klasik të transportit dhe atë jo vetëm atë publikë por edhe procesin e transportit të brendëshëm dhe sistemeve të deponimit, gjegjësisht distribuimit të tërësishëm të mallit. Pika e përbashkët e të gjithë nënsistemeve të teknologjive bashkohore të transportit është shkalla e lart e bashkimit të teknologjive, standardizimi i njësive të ngarkesave dhe bazës teknike të tërësishme e cila përfshin kapacitetet mobile dhe statike në kuadër të teknologjisë së caktuar. Çdo njera teknologji paraqet njëkohësisht edhe rastin klasik të sistemit të përbër dhe është e definuar me elemente të cilët janë ndermjet tyre të lidhur në një tërësi teknologjike, ndersa realizimi i proceseve kryhet në lidhje specifike me rrethinën.

Me aplikimin e teknologjive të reja të transportit janë inicuar ndryshime të konsiderueshme në tregun e shërbimeve transportuese, sepse ajo është si pasojë e zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë dhe realizimi bashkohor i të arriturave transportuese. Kjo rezulton me rritjen e shpejtësisë dhe vëllimit të bartjes të gjitha llojeve të transportit, si dhe kooperimin dhe koordinimin e llojeve të ndryshme të transportit gjatë kryerjes së shërbimeve transportuese në tërë rrugën transportuese nga prodhuesi deri të konsumuesi, me aplikimin e mjeteve dhe teknologjive të ndryshme të transportit. Puna e transportit rrugor është parapare të kryhet në largësit më të vogla dhe përfshirjen e hapsirës gjeografike shërbyese më të gjerë, posaqerisht në kushtet e krizës energjetike, ndersa hekurudha ka koncentruar punën në stacione më të vogla dhe disa drejtime.

Kështu intensifikohet shfrytëzimi i hekurudhave industrijale, njëkohësisht edhe shuarja e hekurudhave jorentabile. Kujdes më i madh i kushtohet standardizimit dhe tipizimit të mjeteve të paketimit të mallit me aplikimin e mjeteve bashkohore transportuese dhe njësive bartëse (paleta, kontejneri, gjysëmrimorkio, enëve të ndashme transportuese, automjeteve rrugore dhe hekurudhore).

Është mjaft prezente aplikimi i automatizimit dhe i drejtimit me procesin transportues, me aplikimin e sistemeve informative bashkohore , modeleve matematikore , kompjutereve etj.

Me hulumtimin kompleks si te atij tekniko-teknologjik ashtu edhe atij komercialo-financiar, synohet optimalizimi i proceseve teknologjike. Faktor i rëndësishëm është formimi dhe zhvillimi i terminaleve te mallrave të përmasave më të mëdha si dhe hallkave të rëndësishme nga sfera e distribuimit të mallit. Kontribut të madh në trendet bashkohore në transport i ipet zhvillimit të terminaleve detare, tokësore dhe të limajve me aplikimin e sistemeve të automatizuara të manipulimit.

Qëllimi i teknologjive bashkohore të transportit nuk është vetem kursimi dhe shpejtësia e bartjes por edhe racionalizimi, thjeshtimi dhe organizimi ekonomik i proceseve transportuese të barjes së mallrave në tërë rrugën transportuese, nga prodhuesi deri te konsumuesi. Këto teknologji do të përmbushin të priturat, nëse çdo pjesëmarrës në transport e shef interesin e tij dhe vjen deri te njohuria se racionalizimi në transport kushtëzon integrimin e tij dhe paraqet udhërrefim në aktivitetet e tij.

Në ditët e sotme shumë shpesh në publikimet profesionale mund të hasim në modele me efekte të ndryshme të teknologjive të caktuara (mendohet për teknologji të avansuara) më ç' rast cekën dhe elementet nga të cilat ato varën.

Kështu p.sh tregohet për :

- ✓ rëndësinë e madhësisë dhe struktures së substratit,
- ✓ kapacitetit të mjetëve transportuese
- ✓ gjendjës së sistemit informative dhe aftësisë së adaptimit në ndryshime
- ✓ aftësimin kadrovik i cila përfshinë edhe njohuërit lidhur më gjendjen në meset e zhvilluara etj.

Një inxhinier i komunikacionit rrugorë nuk duhet të jetë i kënaqur me atë se mirret veç me organizimin dhe veprimin e elementeve ekzistuese të teknologjisë. Sikurse që ngjanë dhe me inxhinierët e profilëve tjera teknike që nuk duhet të jenë të kënaqur vetëm më atë duke inqizuar metodologjitë apo veprimet në fazat e procesit ekzistues ashtu dhe inxhinieri i komunikacionit nuk mund t'i lejoj vehtes të jetë një shikues pasiv, pra i kënaqur vetëm me strukturën ekzistuese.

Ai duhet gjithnjë të shikon përpara dhe të inicon ndryshimin struktural duke gjetur zgjidhje gjithnjë më të mira.

Sot më së tepërmi përdoren këto llojeve te teknologjive te transportit:

- Teknologjia e transporti unimodal -konvencional,
- Teknologjia e transporti modal,
- Teknologjia e transporti bimodal,
- Teknologjia e transporti multimodal,
- Teknologjia e transporti integral,
- Teknologjia e transporti intermodal,
- Teknologjia e transporti të kombinuar.

Vartësisht nga degët e komunikacionit përdoren këto teknologji :

- Teknologjia e komunikacionit rrugor,
- Teknologjia e komunikacionit hekurudhor,
- Teknologjia e komunikacionit ujor,
- Teknologjia e komunikacionit ajror.

Proçeset teknologjike mund të jenë:

- Proçese te llojeve të transportit,
- Proçese te degëve të transportit.

Proçeset e llojeve te transportit mund të jenë:

- ✓ Proçeset e transportit konvencional,
- ✓ Proçeset e transportit modal,
- ✓ Proçeset teknologjike te transportit bimodal,
- ✓ Proçeset e transportit multimodal,
- ✓ Proçeset e transportit integral,
- ✓ Proçeset e transportit intermodal,
- ✓ Proçeset e transportit të kombinuar.

Me nocionin transporti i kombinuari vërtet duhet kuptuar transportin e mallit duke shfrytëzuar së paku dy forma të trafikut. Transporti i kombinuar është transporti i mallit të ngarkuar (njësive transportuese) me mjete transportive të shumë formave të trafiqëve pa ndërruar enën transportuese prej derguesit deri të marrësi. Transporti i kombinuar i pjesëve derguese është ai transport i cili kryhet me aplikimin e paletave dhe kontenjerëve të vegjël. Transporti ndërkombetar multimodal është transport i atillë me të cilin kryhet bartja-transportimi i mallit me anë të dy mjetëve transportuese të ndryshme në mes vendeve të dy shtetëve.

Transport integral duhet kuptuar bartja e njësive ngarkuese transportuese në mes derguesit dhe marrësit me mjete transportuese të formave të ndryshme të trafikut.

Në transportin multimodal automjeti i cili kyçet në procesin transportues e që në fillim të operacionit është ngarkuar dhe barra njëkohësisht është edhe bartësi-transportuesi i barrës në mjetin transportues më të madh dhe vetë bëhet barrë së bashku më barrën që vetvetiu.

I.1.Sistemet e transportit

Këtë teknologji të transportit e karakterizon procesi prodhues i cili realizohet me automjete të destinacionit të përgjithshëm, dhe automjete të destinuara për bartje të veçanta. Ky transport është i veçant për kah lëvizja autonome të një automjeti, autotreni ose grup automjetesh me rend të vozitjes apo pa të. Barra e ngarkuar mund të jetë me dimensione të vogla apo të mëdha

Në këtë teknologji hynë këto sisteme transportuese:

- sistemi transportues me paleta
- sistemi transportues me kontejner(të gjitha llojeve)
- sistemi transportues me rimorkio ose gjysëm rimorkio transportuese
- sistemi i enëve transportuese të ndrueshme.

Kërcënimi nga rritja e paqëndrueshme e sistemeve transportuese në qytetet e mëdha të botës vjen nga ndërveprimi ndërmjet rritjes së kërkesave për shërbimet e transportit dhe impakteve që sjell transporti ndaj mjedisit. Kërkesat synojnë të rriten me progresion gjeometrik, kapaciteti i mjedisit rrethues (në teknologjinë e dhënë) të trajtohet sikurse një zhvillim i ndaluar. Teknologjia ofron mundësi enorme për ndryshime në një periudhë të gjatë, por vetëm nëse shfrytëzohet për qëllime të mbështetjes, mund ta rëndojë me disa probleme (sikurse trafikun e ngopur) ndërsa në proces e sipër e bënë rregullimin e të tjerëve (zvogëlimin e shpenzimeve për kilometër rrugë të automjetit).



Fig.1.1.Qendra e teknologjisë së flotës detare në Trondheim, Norvegji

Një numër i ndikimeve kyçe po drejtohen nga ndryshimi i përshpejtimit teknologjik në transportin tokësor. Trafiku i ngopur po inkurajon teknologji të reja për tu adoptuar në menaxhimin e trafikut. Shqetësimet rreth sigurisë së trafikut po qojnë në interesimin drejt teknologjive të reja, veçanërisht projektin rrugor dhe kontrollin automatik të automjeteve. Disponueshmëria dhe çmimi i vajit të papërpunuar po inkurajon hulumtim dhe zhvillim në industrinë e naftës, përdorimin e lëndëve djegëse alternative, etj. Ndotja ajrore shkakton problem në zonat urbane dhe inkurajon zhvillimin e teknologjive me qëllim të reduktimit të rrezatimeve vdekjeprurëse, dhe shqetësimet për ngrohjen globale kërkojnë vazhdimisht hulumtime për transport me emërtime të ulëta të gazrave dalës.

I.1.1. Sistemi i teknologjisë në transportim

Sistemi teknologjik në transportim mund të analizohet në periudhat e katër mekanizmave të ndryshëm të transmissioinit (transmetimit) që reflektojnë katër periudha të ndryshme të kohës. Mekanizmi i parë i transmetimit, i lidhur me periudhën afatshkurtër që priset nga teknologjitë transportuese, është përhapja e teknologjisë së re, ekonomikisht e arritshme, prodhim i kursyer në emetimin e energjisë. Mekanizmi i dytë i transmetimit nxit risi në fusha specifike të teknologjisë transportuese. Për këtë arsye, kjo risi e nxitur është periudhë afatmesme, sikurse periudha afatshkurtër, ndikon në teknologjitë transportuese. Mekanizmi i tretë i transmetimit është ai i teknologjive me qëllimi të përgjithshëm (TQP) (ang. GPTs – General Purpose Technologies). Përhapja e teknologjive të qëllimit kryesor (GPTs) mund të qojë tek risit shtesë në fusha të veçanta të teknologjisë.

Mekanizmi i katër i transmetimit është hulumtimi publik, zhvillimi dhe ndikimi i tij në teknologjinë komerciale. Volumi dhe kualiteti i hulumtimit bazohet në disiplinat shkencore relevante që do të trajtojnë mjedisin në një periudhë afatgjate për zhvillimet teknologjike në transport.

I.1.2. Teknologjitë me qëllime të përgjithshme

Literatura në teknologjitë me qëllime të përgjithshme trajton një kontekst makroekonomik. Teknologjia me qëllime të përgjithshme është një teknologji që fillimisht ka mjaft mundësi për përmirësim, posedon disa plotësime teknologjike, dhe është përhapur në ndjenjën e të pasurit përdorim të gjerë brenda, dhe herë pas here jashtë sektorit.

I.1.3. Përcaktimi i kriterëve për mënyrën e transportit

Kriterët themelor për mënyrën e transportit janë:

- kualiteti ,
- siguria,
- rregulli dhe shërbimi,
- shfrytëzimi,
- shpenzimet,
- koha e transportit.

Kriteret tjera janë:

- Vlera e mallrave,
- Rregullimi (regjistrimi).

I.1.4. Treguesit e mënyres së transportit

Treguesit e mënyrës së transportit janë:

-Shpejtësia- sa kohë merr një udhëtim (koha transite)

-Shpenzimet - sa kushton një udhëtim

-Depërtimi- mundësia për ta arrit

I.1.5. Teknologjitë bazë të trafikut rrugorë

Teknologjia e transportit të substratit nuk ka ndikim vetëm në çmim por edhe më gjerë, prandaj nuk do të gabojmë nëse interaksionet e mundshme të elementeve të teknologjisë të transportit i radhitim me efektin e sferës së bilardos, e cila e godit me sferë, sferën, ndërsa ajo të treten dhe kështu me radhë, deri sa nuk shteret energjia e goditjes së fillimit.

Nga kjo mund të përfundojmë se në kohën e sotme teknologjia e transportit hyn në fazë të re në të cilën duke marrë për bazë mjetet e punës përvetësojmë edhe simulimet më të ndërlikuara. Në këtë kontribuojnë jo vetëm makinat llogaritëse më bashkëkohore por edhe numri më i vogël i kuadrove qarkulluese në krahasim me veprimet dhe metodat e teknologjive të caktuara.

Gjithashtu ndryshimeve ju kontribuojnë teknologjitë e reja.

Në kohën e sotme, shumë shpesh mundemi me gjet modele verbale të faktorit të teknologjive të caktuara, prej nga rrjedhin edhe elementet prej të cilave ato varen. Kështu p.sh. tregohet në madhësinë valide dhe strukturën e substratit, kapacitetin e mjeteve transportuese, gjendjen informative të përbërjes, aftësinë e përshtatshmërisë në ndryshime, aftësitë profesionale dhe njohjen me gjendjen në mjedise të zhvilluara etj.

Shumica e kuadrove të cilat merren me problemet e teknologjisë së transportit, nuk kanë arritur njohuri teknike dhe praktike të mjaftueshme dhe përvojë e cila është e domosdoshme për prezantimin e gjendjes dhe zhvillimit në të cilin gjendemi sot.

Nuk është e mjaftueshme puna rutinore e themeluar me metoda të vjetra dhe kryesisht me njohuri praktike. Në qarkullimin rrugor më herët ka vepruar teknologji e lehtë dhe e pazhvilluar.

Edhe prodhimtaria industriale gjithnjë e më tepër varet prej teknologjisë së transportit, prandaj nuk është befasi pse ekziston vështërsi për “industrializimin e shërbimit në transport”, jo vetëm në qarqet krijuese por në përgjithësi. Prandaj është menduar “zinxhiri transportues”, i cili nënkupton vendosjen e veprimeve të pandërprera teknike dhe organizative, të lidhura në mes veti dhe të sinkronizuara, të cilat përfshijnë vendosjen e të mirave materiale prej origjine deri te destinimi.

Procesi transportues mund të realizohet me / pa aplikimin e pajisjeve transportuese, ndërsa mundet mu realizu kontinualisht dhe me ndërprerje.

Nëse ndërrohen pajisjet transportuese, atëherë transporti do të jetë me përbërje integrale ose multimodale.

- Integrale është nëse ndërrohet vetëm mjete transportues, ndërsa substrati mbetet i njëjtë.
- Multimodale është nëse procesi transportues i filluar vazhdon transportin me të njëjtin transport të filluar më parë së bashku me substratin.

Në terminologjinë profesionale, gjerë të paraqitja e teknologjive bashkëkohore, mos të themi shumë pakë apo fare nuk është përdorur termi teknologji e transportit ,ndërsa aktivitetet të cilat i përmban teknologjia janë futur në atë, ku më së shpeshti flitet për „organizimin dhe eksplotimin. Me paraqitjen e teknologjive të reja, fillohet të përdoret emërtimi ”Teknologjia e transportit,,

Duke u nisur nga definimi i teknologjisë së trafikut rrugorë pra në fazën e tanishme të zhvillimit të trafikut rrugorë të flitet për:

- teknologjisë klasike të trafikut rrugorë,
- teknologjiitë bashkëkohore të trafikut rrugorë.


I.1.5.1.Objektivat e teknologjive të transportit rrugorë

Në kushtet e tanishme në të cilat jetojmë, mjetet dhe kuadrat me të cilat disponojmë në përgjithësi më pakë janë të prirur ose fare pak janë të prirur ‘veprimeve’ të tepërta apo të bëjnë “gabim në hapa”.

Jo pa kuptim, bëhet përpjekje që të prognozohet dhe të planifikohet çdo aktivitet jetësor, prej asaj më të përgjithshme deri të ajo më e ndërlikuara. Prandaj, dhe teknologjia e trafikut rrugor s’ka pse të përjashtohet.

Duke pasur parasysh operimin, në lëmin e trafikut rrugorë mund të flitet për qëllime të ndryshme të cilat tregojnë ”çka duhet bërë”, “çka mund të bëhet” dhe “çka do të bëhet”. Në teknologjinë e trafikut rrugorë është e domosdoshme të dallojmë qëllimet dhe në funksion të

kohës, sepse ky është sistem i ndërlikuar dhe i rezistueshëm në ndryshime, aq më tepër kur mungon ndikimi i rrethinës.



Objektivat dhe konditat e realizimeve në transportin rrugor

Prej qëllimeve të përgjithshme, të cilat duhet përmendur kudo që bëhet fjalë për transportin rrugorë, duhet dalluar:

- rritja e aftësisë bartëse transportuese të mjeteve të transportit,
- rritja e përshtatshmërisë së mjeteve të transportit rrugorë për degët tjera të transportit,
- zvogëlimin e shpenzimeve operative,
- zvogëlimin e aksidenteve,
- zvogëlimin e kohës së transportimit.

I.2. Teknologjia e transportit hekurudhor

Është posaqerisht e ndërlikuar për shkak të lidhjes së kushtëzuar me binaret e hekurudhës. Bazën e teknologjisë së transportit hekurudhor paraqesin:

- rendi i vozitjes ,
- plani i formimit të trenave sipas drejtimeve të levizjeve,
- përshtatësmeria e planeve të formimit të trenave në linjat magjistrale me trenat në drejtimet kyçëse.

Është e rëndësishme që në pjesën e hekurudhës ndërmjet dy stacioneve nuk mund, njëkohësisht, të qarkullojnë dy trena. Levizja është e lejuar vetëm e trenave të cilët janë parapa sipas rendit të vozitjes. Drejtimi me procesin e transportit bëhet nga Qendra dispeçerike.

Në këtë teknologji hynë këto sisteme transportuese:

- sistemi transportues me paleta
- sistemi transportues me kontejner(të gjitha llojeve)
- sistemi transportues me rimorkio ose gjysëm rimorkio transportuese të komunikacionit rrugor të ngarkuara në vagona transportues të trenit

I.3. Teknologjia e transportit ujqor

Kjo teknologji transporti përfshin transportin e objekteve vetëlevizëse, platformave (barzhave) jovetëlevizëse, sistemin (trenin) me 6-8 platforma (barzha) etj. Me ndihmën e një anije ose sistemit të trupave lundrues të lidhur mund të përcillet barra (malli) në një apo më shumë adresa.

Në këtë teknologji hynë këto sisteme transportuese:

-sistemi i transportit me ISO-kontejnera

-sistemi i transportit me njësi ngarkuese (automjet transportues i komunikacionit rrugor ose vagon i transportit hekurudhor), që përdorën këto teknologji:

- **Ro-Ro** (Roll-on / Roll-off) - Ngarkim shkarkimi horizontal
- **Lo-Lo**(Lo-on / Lo -off) - Ngarkim shkarkimi vertikal
- **Ro-Lo**(Roll-on /Lo- of) - Ngarkimi horizontal , shkarkimi vertikal
- **Lo-Ro**(Lift-on/Roll-off) - Ngarkimi vertikal , shkarkimi horizontal
- **Ro,Lo-Ro,Lo**(Roll-on .Lift-on / Roll-of, Lift-off) – Special :Ngarkimi horizontal dhe vertikal , shkarkimi horizontal dhe vertikal

KAPITULLI II

II. SISTEMET E TRANSPORTIT INTERMODAL

Kuptimi i transportit intermodal rrjedh nga fjala latine “inter” në dy kuptime:

- si pjesë e parë e fjalës do të thotë që diçka gjindet ndërmjet pjesëve të asaj që thuhet në pjesën e dytë të fjalës,
- si pjesë e parë e fjalës që shënon internacionale;”modus” në kuptimin e llojit, mënyrës dhe “multus” në kuptimin shumë ose më tepër të diçkafit.

Teknologjia e Transporti Intermodal (*ang. Intermodal Transport*) është teknologji transportuese në të cilën, mallrat transportohen në të njëjtën njësi ngarkese duke përdorur pa ndërprerë disa degë të transportit por brenda një hapësire të brendshme në të cilën paraprakisht realizohet një proces intern- i brendshëm nacional dhe pastaj procesi transportues vazhdon në më së paku ndërmjet dy shteteve

Me transportin intermodal nënkuptojmë transportin e mallrave në një njësi të transportit pa pasur kontakt me mallin. Koncepti transporti intermodal është një term i gjerë, dhe ai mbulon pothuajse të gjitha teknologjitë e transportit.

Qëllimi kryesor i transportit intermodal është transporti i shpejtë, i sigurt dhe me cilësi të lartë të mallrave, ndërsa shpenzimet minimale që duhet të merren nga prodhuesi deri te konsumatori. Mjetet teknike në teknologjinë intermodale paletat, kontejnerët apo njësitë e transportit janë futur në mes të ngarkesës dhe mjeteve të transportit. Në fillim të viteve të 30-ta duheshin përafërsisht tri ditë për të shkarkuar vagonin e trenit i cili përmbante 13,000 kuti me konzerva të cilat nuk ishin të paletizuara. Me paleta dhe pirunierë, një detyrë e tillë do të kryhej në periudhë prej afërsisht katër orëve.

Teknikat më të mira dhe njësitë menaxhuese për transferimin e transportimit nga një metodë në tjetrën kanë lehtësuar transferimet intermodale. Shembujt e mëhershëm përfshijnë sistemin e ashtuquajtur “piggyback” (fig.2.1), ku gjysmë rimorkiot e kokave tërheqëse apo kontejneret janë të vendosura në vagona të trenit.




Fig.2.1. Sistemi "piggyback".

Intermodaliteti rritë rezultatin ekonomik të një rrjeti të transportit duke përdorur format më produktive. Në këtë mënyrë ekonomit e linjave të transportit mund të jenë vënë në shfrytëzim për distanca të gjata me veprim të kamionëve duke siguruar pranimet dhe dërgesat lokale. Çelësi është se i tërë udhëtimi shihet si një tërësi, më saktë si një veprim individual me rreth të ndarë të dokumentacionit dhe taksave.

Në këtë mënyrë sistemet e transportit duke pasur mënyra të shumta mund të konsiderohen nga dy perspektiva të ndryshme konceptuale:

Rrjeti i transportit intermodal

Është sistem i lidhur logjistik duke ofruar sistem me përdorim të dy apo më shumë mënyrave transporti me një njësi të vetme. Mënyrat duke pasur karakteristika të zakonshme përdorimi, duke lejuar ngarkesat (ose njerëzit) transferohen nëpërmes veprimeve gjatë një lëvizjeje nëpërmes një zanafille apo një destinacioni.

Rrjeti i transportit multimodal

Është vendosja e mënyrave transportuese duke ofruar lidhjet prej origjinës deri te destinacioni. Figura 2.2. ilustron dy mundësi të shpërndarjes së mallrave.




Fig.2.2. Rrjeti i transportit Intermodal dhe Multimodal

Rrjeti tradicional është pikë në pikë ku origjinat (A,B dhe C) janë në mënyrë të pavarur të lidhura me destinacionin, (D,E dhe F).Në këtë rast dy format (modet-rrugë dhe hekurudhë) janë të shfrytëzuara.

Rrjeti i integruar përfshinë zhvillimin e një rrjeti të integruar të transportit intermodal. Trafiku takohet në dy pikat e integritimit, терминаlet hekurudhore ku bëhet ngarkimi. Kjo mund të rezultoi në një faktor më të lartë të ngarkimit dhe/ose frekuencë më të lartë të transportit, veçanërisht ndërmjet terminaleve. Nën këto kushte efikasiteti i një rrjeti të tillë qëndron në mundësitë e transferimit që ofrojnë терминаlet e transportit

Teknikat për transferimin e ngarkesave nga një mënyrë në tjetrën kanë lehtësuar transferet intermodale shembujt e më hershem duke përfshirë transportin me platformë (TOFC Trailers On Flat Cars - rimorkiot në vagonët e rrafshite hekurudhor) ku vagonët e mallrave janë vendosur në binarë dhe LASH (më lehtë në bordin e anijes), ku barkat motorike lumore (të lumenjve) janë vendosur drejtpërdrejtë në bordin e anijeve oqeanike.

Zhvillimi më i madh pa dyshim ka qenë kontejneri që lejon përdorim nëpërmjet sistemeve modale dhe masa e dyfishuar e kontejnerëve në hekurudha. Kontejnerët në vagonët me dysHEME të ulte kanë dyfishuar kapacitetin e trenave që bartin ngarkesat me rritje minimale të shpenzimeve me anën e kësaj duke përmirësuar pozitën konkurruese të hekurudhave me vlerësim shkëmbimi për ngarkesa në transportim të largët. Kontejnerët janë bërë komponent më i rëndësishëm për transport intermodal hekurudhor dhe detar.

Trendët në lidhje me transportin e mallrave duke përdorur rimorkiot mbi binar (TOFC) dhe kontejnerët dykatësh (COFC) tregojnë ilustrimet në lidhje me rritjen e përdorimit të transportit intermodal. Për këtë shkak të mundësive të tij të mëdha kontejneri është një mjet shumë i favorizuar në transportin e mallrave.

Tipari më i rëndësishëm i intermodalizmit është pagesa e shërbimit me një tiketë (për udhëtarët) ose me një polisë të ngarkesës (për mallra). Kjo e ka kushtëzuar një revolucion në organizimin dhe në kontrollin e informatave. Në zemër të intermodalizmit bashkëkohor është manovrimi me të dhëna, sistemi i përpunimit dhe i shpërndarjes të cilët janë të nevojshëm për të rritë sigurinë, besueshmërinë dhe kontrollin e shpenzimeve efikase të ngarkesës dhe të udhëtareve të cilat janë transportuar me disa rrugë. Shkëmbimi i të dhënave elektronike është një teknologji e cila po e ndihmon teknologjinë dhe agjencitë qeveritare që të përballen me një rritje të ndërlikuar të sistemit të transportit global..

Kufijtë e intermodalitetit janë të imponuara nga faktorët e ndryshëm si:

- ✓ hapësira,
- ✓ koha,
- ✓ forma,
- ✓ modeli i rrjetit,
- ✓ numri i nyjave dhe i lidhjeve
- ✓ tipi dhe karakteristikat e makinave dhe терминаlet.

Intermodaliteti mund të konceptohet si kalim prej një mënyrë të transportit në tjetrën, dhe varet prej:

- llojit dhe sasisë së mallrave transportuese,
- mënyrave të transportit të aplikuar,
- vendit të origjinës dhe i destinacionit,
- kohës dhe shpenzimeve të transportit,
- vlerave të mallrave,
- shpejtësisë së transportimit.

II.1. Intermodalizimi, transporti detar me kontejner

Intermodalizimi filloj në hapësirat detare, me zhvillimin e kontejnerëve në fund të viteve të 60-ta, dhe qysh atëherë ka filluar të bashkoj edhe mënyrat tjera të transportit. Nuk është e çuditshme që transporti detar ka qenë mënyra e parë e cila ka pranuar kontejnerizimin. Ajo ishte mënyra që merrte më shumë kohë në ngarkimin dhe shkarkimin anijeve.

Kontejnerizimi mundëson manovrimin me mekanizma të ngarkesave të llojeve dhe të dimensioneve të ndryshme të cilat janë të vendosura në kuti me dimensione standarde. Në këtë mënyrë të mirat materiale të cilat mund të merrnin disa ditë për ngarkimin apo shkarkimin e tyre prej anijeve, tani ajo bëhet për disa minuta.




Fig.2.3. Ndikimet e lundrimit detar në zinxhirin transportues

A- një zinxhir i transportit standard duke përfshirë transportin hekurudhor ose rrugor dhe intermodalizimin në dy porte detare.

B- kur është e mundur zinxhiri i transportit mund të përdor portet lumore (Fp) me ngarkesa të bëra në porte detare.

C- me lundrim detar ose lumor, është e mundur që të shmangen portet detare dhe të shkohet nga një port në tjetrin. Ky është rast zakonisht në Evropën perëndimore kur portet lumore të Gjermanisë mund të lidhen me ato të Anglisë.

Risit teknologjike dhe zhvillimet infrastrukturore mund të kenë ndikime të rëndësishme në zinxhirin e transportit ndërmjet vendit të origjinës (O) dhe destinacionit (D). Një inovacion i tillë është edhe lundrimi detar.

Kontejnieri është një njësi e ngarkimit e cila mund të përdoret në disa mënyra të transportit.

Në fakt, kontejneri është i përdorshëm për transportin detar, hekurudhor dhe rrugor, duke e bërë atë llojin kryesor në transportin intermodal. Përdorimi i kontejnerëve tregon lidhshmërinë ndërmjet mënyrave të transportimit të ngarkesave duke ofruar një lidhshmëri më të madhe të lëvizjeve dhe një standardizim të ngarkesës. Njeri prej çelësave të suksesit të kontejnerëve është që organizata ndërkombëtare e standardeve (ISO) shumë herët ka përcaktuar dimensionet bazë të kontejnerëve. Madhësia e përmendur është një kuti 20 Ft, 20 Ft e gjatë, 8 Ft e lartë dhe 8 Ft e gjerë ose 1 njësi = ekuivalente me 20 Ft (TEU).

Dimensionet e tjera të mëdha janë kutia 40 Ft e cila ka kapacitet që të bart 267,000 video lojëra ose 10,000 palë këpucë, e barabartë me rreth 22 tonë ngarkesë. Kontejnerët janë të punuar prej çelikut ose prej aluminit dhe struktura e tyre ofron (fleksibilitet) dhe qëndrueshmëri. Çdo vit rreth 2 milion kontejner në njësi TEU prodhohen.

Inventari global i kontejnerëve ishte paraparë që të jetë 21 milion TEU në vitin 2005. një kontejner 20 Ft standard kushton rreth 2000 dollar ndërsa ai 40 Ft rreth 4000 dollar. Nder shumë përparësi lidhur me suksesin e kontejnerëve në transportin intermodal po i përmendim disa:

Prodhimi i transportit standard

Një kontejner mund të përdoret kudo qoftë në botë nëse dimensionet janë sipas standardit ISO. Në fakt infrastruktura e transferimit iu mundëson të gjitha elementeve (makina) të zinxhirit të transportit një manovrim relativisht të lehtë.

Fleksibiliteti i përdorimit

Ky është lloji i shërbimit të mjeteve rrugore dhe hekurudhore është një projekt i përbashkët ndërmjet transportit rrugor dhe hekurudhor, e cila është një lidhje racionale, duke bërë të mundur realizimin e transportit "derë më derë". Në këtë mënyrë, përfitohet nga avantazhet e veçanta të hekurudhave për një transport të rregullt, të sigurtë, të shpejtë dhe ekologjikisht të përshtatshëm, duke transportuar sasi të mëdha të mallrave në distanca të gjata në konsum relativisht të ulët të energjisë, e cila është shumë e rëndësishme në shpenzimet e përbashkëta, si dhe mobilitetin e transportuesve në zbatimin e shërbimeve të transportit rrugor.

Në këtë sistem nuk përdoren mjete të vecanta për tërheqje, gjithashtu arrihet një proporcion (raport) më i mirë në mes peshës së dobishme - ngarkesës dhe peshave vetanake se sa në Huckepack A, e pak më dobët se në Huckepack C, me një proporcion **60 : 40**.




Fig.5.1. Teknologjia Huckepack B

Ngarkimi dhe shkarkimi bëhet në stacionet e terminaleve me ndihmë të mjetit tërheqës të rimorkios apo gjysmë-rimorkios, i cili zhvendoset prapa, e që për vendosje të ngarkesës në pjesën e vagonit përdoren rampat. Mundësia tjetër e manipulimit është edhe ajo vërtikale, duke përdorur vincat portal të vecantë për vagonë të posacëm.

Duke e ndarë mjetin tërheqës prej rimorkios apo gjysmerimorkios zvogëlohet në masë të konsiderueshme kostoja e transportit të këtyre njërive transportuese. Poashtu edhe mos përfshirja e ngasësit të mjetit transportues rrugor gjatë transportit hekurudhor ndikon në zvogëlimin e kostos së operimit, ku ky ngasës për pjesën tjetër të kohës mund të angazhohet diku tjetër.

Përparësitë e teknologjisë Huckepack B

- Vagonët hekurudhor nuk kërkohet të jenë të pajisur me pajisje shtesë ku në këtë mënyrë zvogëlohet pesha e vagonit duke e përmirësuar raportin e peshës së dobishme dhe te pa dobishme per 40 %.
- Në një masë të konsiderueshme masat vetanake redukton kohën e punës për njësi transportuese, ku për ngarkim-shkarkim të gjysmë-rimorkiove duhen vetem 4 minuta.
- Terminalet e mëdha ku aplikohet teknologjia Huckepack janë të pajisura me pajisje për ngarkim-shkarkim, duke lejuar jo vetem manipulimin me kontejnerët por edhe me gjysmërimorkiot, dhe kjo arrihet pa ndonjë punë shtesë apo ndonjë përshtatje të veçantë të makinerive gjatë operacionit.
- Trajtim më i lehtë sepse nuk kërkohen të përdoren litar, nuk nevojitet që kamioni të posedoj rampat për ngarkimin e gjysmërimorkios në vagon.
- Konsumet dhe dëmtimet në mjetin rrugor janë të vogla dhe në këtë mënyrë mundëson jetëgjatësi më të madhe.

Këto avantazhe merren në konsideratë për përdorimin e kësaj teknologjie dhe vagonët të cilët kanë një dizajn të thjeshtë dhe peshë më të vogël se vagonët e zakonshëm për 8 tona.

Të metat e teknologjisë Huckepack B

Te teknologjia B, në raport me teknologjisë A dhe C janë evidentuar këto të meta:

- Kjo teknologji është përdor zakonisht për vagonet me dysHEME të ulët (xhepa), e cila gjithashtu duhet të ketë pajisje shtesë. Poashtu edhe projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e vagoneve është më e shtrenjtë krahasuar me vagonët tjerë hekurudhor,
- kamionët me rimorkiot e përdorur në këtë teknologji e kanë të veshtirë të lëvizin në rrugë për shkak gjatësisë së tyre,
- duhet ti kushtohet shumë kujdes gjatë transportit në rrugë dhe sigurimit të ngarkesave.

Kjo teknologji karakterizohet me mënyren e ngarkimit dhe shkarkimit të rimorkiove dhe gjysmërimorkiove me ngarkesë ose pa ngarkesë në vagonë të veçantë hekurudhorë.

Ngarkimi dhe shkarkimi mund të bëhet në dy mënyra :

- Kur shoferi me mjetin tërheqës (kamion) lëviz prapa, përmes rampave të vecanta e ngarkon rimorkion apo gjysmërimorkion në mjetin hekurudhor, gjithashtu edhe procesi i shkarkimit zhvillohet në të kundërtën e ngarkimit, –*Teknologjia horizontale e ngarkimit (Fig.5.2).*
- Kur ngarkimi dhe shkarkimi i rimorkios apo gjysmërimorkios kryhet duke përdorur vinça të vecantë – *Teknologjia vertikale e ngarkimit (Fig.5.3).*



Fig.5.2. Mënyra horizontale e ngarkimit (përmes rampave)



Fig.5.3. Mënyra vertikale e ngarkimit (përmes vinçave portal)

Nëse ngarkimi bëhet me anë të vinçit të lëvizshëm (jo atij portal), atëherë ngarkimi ndryshon, përmes një kornize drejtëkëndeshe dhe tre qifte zinxhirësh. Qifti i parë vendoset në pjesën e përparme të gjysmërimorkios ndërsa dy qiftet tjera në rrotat e prapme (Fig.5.4.). Gjatë ngarkimit gjysmërimorkioja duhet të vendoset në pozicionin e duhur si në siguresit e rrotave, poashtu edhe në pjesën e përparme të saj.




Fig.5.4. Mënyra e ngarkimit të gjysmërimorkios me vinç të lëvizshëm.

Para se të bëhet ngarkimi i gjysmerimorkios në mjetin hekurudhor, ngarkesa duhet të përforcohet me shasinë e gjysmerimorkios nga pjesa e prapme me një përforcues metalik, anash përforcohet me levat sigurorese (Fig.5.5.).




Fig.5.5. Përforcimi i gjysmerimorkios.

Rimorkioja apo gjysmërimorkioja gjithashtu në pjesët anësore duhet të ketë edhe shënimin se në cilin vend të vendosen pjeset e vincit portal, në mënyrë që të eliminohen dëmtimet e mundshme (Fig.5.6.).

Ky shënim në formë katrore duhet të jetë me ngjyrë të verdhë.



Fig 5.6. Shenja në pjesët anësore për vendosje të vincit për ngarkim.

Përparësitë e sistemit vertikal përkundër atij horizontal :

- Vagonët e hekurudhës nuk duhet të jenë të pajisur me pajisje shtesë, ku me këtë, zvogëlohet pesha e padobishme e trenit dhe përmirësohet ,
- zvogëlohet koha operative për njësi të transportit,
- shumica e terminaleve të transportimit me platformë janë të pajisur me vinca të vecantë për ngarkim-shkarkim i cili i mundëson ngarkim-shkarkimin e rimorkiove dhe gjysmerimorkiove.

Përparësitë e sistemit horizontal përkundër atij vertikal :

- Sistemi i ngarkimit horizontal nuk kërkon pajisje speciale (vinca), por vetem rampa të ngarkim-shkarkimit,
- sistemi horizontal nuk kërkon fonde të konsiderueshme dhe investime për ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore në terminalet e transportit me platformë.

Shënimet në mjetet transportuese të teknologjisë Huckepack**Tabela e vendosur në mjetin transportues rrugor**

Tabela, e cila është e vendosur në një gjysmë-rimorkio, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme, të cilat duhet të jenë të shtypura lexueshëm dhe të tregojnë në mënyrë të qartë:

- Njësitë e ngarkimit dhe përshtatshmërinë për një lloj të veçantë të vagonëve,
- numri i kompanisë kombëtare të transportit me platformë,
- një numër identifikimi i pronësisë së njësisë ngarkuese,
- numri i njësive të brendshme të ngarkuara,
- numri i regjistrimit dhe viti i prodhimit,
- numri i shasisë dhe njësisë së ngarkimit etj.

Shenjat e vendosura në vagonë të transportit të kombinuar

Organizimi i transportit të kombinuar duhet të jetë efikas dhe në përputhje me rregullat e trafikut, prandaj duhet njohur llojet e vagonëve dhe qëllimin e përdorimit të tyre. Mbishkrimet mbi vagonë duhet të përputhen me rregulloren e UIC, e cila shkruhet në të dy anët e mjetit transportues dhe përmbanë informacionet e mëposhtëme:

- Numrin dymbëdhjetëshifror në vagon,
- serinë alfabetike për caktimin e nëngrupit të vagonit,
- masën vetanake në kilogram,
- ngarkesa maksimale në ton,
- sipërfaqja ngarkuese metra katror,
- vëllimi ngarkues në metër kub,
- gjatësia në m,
- gjatësia e vagonit mbi mbulesë në m.

Infrastruktura e terminaleve të sistemit të transportit Huckepack

Terminalet në të cilat aplikohet teknologjia Huckepack janë të pajisura posacërisht dhe janë të pozicionuar në nyjet e trafikut ku ndërliidhen trafiku rrugor me atë hekurudhor ashtu që mundësohet transformimi apo kombinimi i ngarkesave mbi vagonë të posacëm hekurudhor dhe anasjelltas. Poashtu duhet të posedojë infrastrukturë të posacme dhe superstrukturë të përshtatshme për zhvillimin e teknologjisë së transportit me platformë.

Terminalet Huckepack posedojnë elemente të shumëta përcjellëse (Fig.5.7.):

- binarë hekurudhor,
- rrugët e mbërritjes, largimit dhe ngarkimit të automjeteve rrugore,
- hapësira të destinuara për marrjen, ruajtjen dhe transferim,
- deponim dhe magazinim,
- garazhe dhe punëtori riparimi,
- vinça fiks për manipulim me ngarkesa,



Fig .5.7. Terminale të teknologjisë Huckepack.

KAPITULLI VI

VI. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK C

Një prej paisjeve standarde për transportin e mallrave në transportin rrugor dhe hekurudhor është arka e hershme “swap body”.

Pra kjo teknologji kërkon ekzistimin e arkave të heqshme transportuese të kamionit dhe kontenjerët të cilët janë të pajisur me pajisje special, respektivisht pajisje për përforcimin e tyre.

Teknologjia Huckepack C (swap-body) përbëhet nga ngarkim shkarkimi i kutive të projektuara dhe të standardizuara si kontenjerët , që ngarkohen vertikalisht mbi vagonë me vinça të veçant të levizshëm.

Arkat e heqshme të kamionëve ngarkohen me ngritje të vinçave të veçant ose përmes manipulatoreve. Shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve është njëra nga përparsitë kryesore të tyre ndërsa e meta kryesore është gjatë deponimit vendosen në këmbët adekuate që pamundësojnë deponimin në lartësi. Arkat e heqshme transportuese paraqesin hapsirën ngarkuese të mjetit rrugor-arkën që mund të largohet nga shasia e mjetit rrugor.

Ende deri më sot nuk është dhënë një përgjigje e qart se në ç’farë mase bartja e arkave të heqshme transportuese mund të merret si pjesë e transportit Hyclepack, dhe kur i takon sistemit të kontenjerëve të mëdhenjë.



Fig 6.1. Kamioni



Fig .6.2.Koka tërheqëse



Fig.6.3.Arkat e heqshme

Arkat e heqshme (Fig.5.3.) sikurse kontejnerët janë te pajisura me pajisje për përforsim dhe sigurim gjat kohës së transportit.

Arkat e heqshme zakonisht janë më të shtrenjta se sa ISO kontejnerë. Ky çmim i lartë është për shkak se ISO kontejnerët që përdoren në Evropë janë prodhuar në Kinë, ndërsa arkat e heqshme prodhohen në Evropë (kryesisht në Britani të madhe). Janë më të shtrenjta pasi që pesha e lehtë e trupit e kompenson këtë kosto në kursimet e karburantit gjatë transportit dhe rritjen e kapacitetit të ngarkesës.



Fig .6.4. Arkat e heqshme

Arkat e heqshme normalisht kanë të njëjtat dimensione të jashtme, pajisje fund dhe skaje si kontejnerët e anijeve ISO, prandaj mund të vendosen në të njëjtat lloje të kamionëve, rimorkio dhe mjete hekurudhore të projektuara për kontejnerë.

Shumë arka të heqshme janë të pajisur me katër këmbë palosëse që janë pjesë përbërse e tyre. Këto këmbë (Fig.6.4.) mundesojn ndryshimin e mjetit transportues nga njëri mjet në tjetrin, ose ruajn destinacionin, pa përdorur pajisje.

Arkat e heqshme mund të kenë më shumë dyer ose panele se arkat e zakonshme të kamionëve, mjeteve hekurudhore, ose kontejnerë të anijeve. Kjo veti mundëson shkarkimin dhe ngarkimin më të shpejtë dhe më të lehtë (Fig.6.5.).



Fig 6.5.Hapësira për ngarkesë e arkës së heqshme

6.1. Mjetet për punë

Mjetet më të rëndësishme që përdoren në dteknologjin HUCKEPACK në transport janë:

1. automjetet rrugore speciale transportuese apo pjesë të këtyre mjeteve, dhe kontenierë të këmbyeshem

Problemi më i rëndësishëm teknik, teknologjik dhe organizativ i transportit rrugor-hekurudhor është profile hekurudhor ose dimensionet të cilat përcaktojnë dimensionet maksimale të jashtme veqanërisht lartësin dhe gjerësinë e automjeteve për transport të madhërave.

Në shumicën e vendeve evropiane lartësia maksimale e lejuar është 4 metra, dhe gjerësi prej 2,5 m.

2. Terminalët Huckepack me infrastrukturë të veçantë dhe superstrukturë.

Terminalët Huckepack janë ndërtuar posaçërisht dhe të pajisur me objektet dhe shpërndarës të transportit ku ata përballen me trafikun rrugor të këmbyeshem me ngarkesë mbi vagonë të posaçëm hekurudhore dhe anasjelltas, dhe duhet të kenë një infrastrukturë të posaçme të transportit dhe superstrukturës teknologji të përshtatshme të transportit.

Terminalët Huckepack kanë burime të ndryshme dhe të shumta për punë:

- Gjurmët e hekurudhave
- Rrugët për mbërritje, largim dhe ringarkimin
- Hapësira dekoruar për marrjen, ruajtjen dhe transferim
- Garazhe dhe punëtori - riparim
- Vinça të veçanta fikse në mënyrë të vendosur për trajtimin e ngarkesave
- Objekte të tjera fikse në mënyrë të vendosur dhe pajisjet

6.2. Përparsitë e Huckepack teknologjise C

Transport Huckepack përfaqëson një lidhje efektive dhe racionale në mes të rrugës dhe të trafikut hekurudhor dhe siguron një transport të kombinuar të mallrave "derë më derë", të sigurt, të shpejtë dhe racionale.

-Përdoret për distanca transportuese mbi 300 km,

-Në Hekurudhat zakonisht bëhen trenat homogjene ose bllok, në të cilin shpenzimet minimizohet, dhe dëmtimi i dërgesave është minimale,

-Ndikim pozitiv në sigurinë dhe shpejtësinë e transportit të mallrave, por edhe uljen e manipulimit dhe shpenzimeve.

Rezultatet aktuale kërkimore dhe përvoja shumë pozitive në zbatimin e teknologjisë së transportit me platformë pa dyshim çojnë në përfundimin se kjo teknologji ka të gjitha supozimet përkatëse për zhvillim edhe më të shpejtë.

Përfitimet e transportit me platformë të trafikut për kompanitë e transportit të mallrave :

- Reduktimi i kostos për karburante motorike, pjesë këmbimi, mirëmbajtjen parandaluese dhe investimeve në automjete,

- Kursimeve në tarifatat për ngasje dhe pushim,

- Kursimeve në orët efektive të makinës, dhe orët efektive të punës së drejtuesve të automjeteve.

Bazuar në përvojën e transportuesve rrugore një nga avantazhet është për të ulur shpenzimet për shoferët dhe udhëtarët janë deri në 30% të kostove totale operative të kompanive rrugore.

Në mënyrë që të përcaktoj avantazhet dhe disavantazhet e secilës teknologjisë huckepack individualisht, me një argument të madh dhe të besueshëm të sigurisë mund të jetë bërë që teknologjia transportuese me platformë C ka përparësi të përgjithshme në krahasim me transportin me platformë teknologjike A dhe B, pastaj transporti me platformë teknologji B ka përparësi të përgjithshme në krahasim me transportin me platformë teknologji A. Këto pretendime janë të bazuara shkencërisht në rezultatet e kërkimit të aplikuar dhe përvojat e përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve në komunikacionin transporti me platformë gjermane. Nga kjo ne mund të konkludojmë se përdoruesit duhet të përdorin transportin me platformë C, pastaj transportim me platformë të teknologjisë B, dhe veten në raste të justifikuar transportim me platformë të teknologjisë A.

KAPITULLI VII

VII. TEKNOLOGJIA HUCK-PACK D

Teknologjia bimodale paraqet një formë të veçantë të transportit të kombinuar rrugor-hekurudhor. Për herë të parë është paraqitur në Amerikë në vitin 1950, dhe pastaj edhe në Angli, Itali, Francë, Norvegji dhe në vende të tjera. Ideja ka qenë që të bëhet një makinë transportuese që do të mund të lëviz nëpër rrugët dhe nëpër hekurudht, me shpenzime sa më të vogla dhe me kohë më të shkurtë të ringarkimit. Makinat e këtilla të quajtura “Roadrailer” ishin në mundësi lehtë të bashkëngjiten si një pjesë të dërgesave të veçanta të trenit transportues ose udhëtues (Fig. 12a), ose, megjithatë, me to të formohet një tren i veçantë i plotë i quajtur treni “Trailer”, dhe teknologjia “Semi Trailer”.

a)



b)



Figura.7.1. Teknologjia bimodale: a) Bashkëngjitja e makinës udhëtuese në kuadër të boshtit; b) treni përbërës

Kjo makinë transportuese mund të ndahet nga grupi boshtor hekurudhor, i cili mbetet në hekurudhën dhe nuk paraqet ngarkesë shtesë në transportin rrugor (Fig. 7). Transferimi nga një lloj transporti në një lloj tjetër është 5 minuta dhe nuk kërkon pajisje të veçantë për ringarkim.



Figura.7.2. Grupet boshtore hekurudhore për bashkëngjitje të makinave udhëtuese

Qëllimet më të rëndësishme të teknologjisë bimodale janë:

- Lidhja e sigurt, e shpejtë dhe racionale e transportit rrugor dhe hekurudhor pa ringarkim të ngarkesës nga makina rrugore në makinën hekurudhore;
- Përshpejtim i manipulimit dhe transporti i ngarkesës në transportin rrugor-hekurudhor, dhe me atë edhe minimizim ose përjashtim i tërësishëm të forcës së punës;
- Shfrytëzimi më i mirë i infrastrukturës rrugore, dhe para se gjithash, hekurudhore;
- Zvogëlim i shpenzimeve për ringarkim në терминаlet, për të cilat nuk janë të nevojshme investime shtesë;
- Zvogëlim i masës së përgjithshme të makinave hekurudhore dhe rrugore etj.

Në Evropë teknologjia bimodale është e njohur me emrat e mëposhtme:

Kombitrailer në Norvegji dhe në Gjermani, CodaE në Suedi, Transtrailer në Spanjë, Sami Rail në Francë, Trailer Train në Norvegji etj.

VII.I. Manipulimi me njësitë ngarkuese te teknologjia D (Teknologjia Bimodale)

VII.I.1.Nocioni dhe zhvillimi I teknologjisë

Teknologjia bimodale e transportit është teknologjia specifike e transportit për të cilën është karakteristik transporti i gjysmë-rimorkiove speciale rrugore me ngarkesën sipas rrugës dhe hekurudhës. Kjo teknologji mundëson „transformim” të gjysmë-rimorkiove rrugore, që në mënyrë klasike e transportojnë ngarkesën në komunikacionin rrugor në „vagona” ngarkues të veçantë hekurudhorë. Ky transformim i gjysmë-rimorkiove rrugore speciale në automjetet speciale tërheqëse, përkatësisht vagonët për transportimin e ngarkesës arrihet me modelet e ndryshme të automjeteve rrugore-hekurudhore që përbëhen nga shasitë e pavarura hekurudhore dy boshtore dhe gjysmë-rimorkiot rrugore me instalimin e ndërtuar për përforcimin e shasive dhe kyçjes në përbërjen bimodale.

Qëllimet më të rëndësishme të teknologjisë bimodale të transportit janë:

- ndërlidhja e shpejtë dhe racionale e sigurt e transportit rrugor dhe hekurudhor pa mbingarkim të ngarkesës nga automjetet rrugore në ato hekurudhore,
- përshpejtimi i manipulimit dhe transportit të ngarkesës në komunikacionin e kombinuar rrugor-hekurudhor,
- optimizimi i efekteve në infrastrukturën dhe suprastrukturën rrugore dhe hekurudhor
- maksimizimi i efekteve i punës së teknikëve të komunikacionit, dispeçerët operativ dhe pjesëmarrësit e tjerë në përbërjen e transportit biomodal.

Teknologjia e parë biomodale e transportit është e njohur nën emrin Mark IV Road Railer, Mark V Road Railer dhe Mark V SST Road Railer dhe është zhvilluar në ShBA. Gjysmë-rimorkiot rrugore-hekurudhore ngarkuese kanë ndërlidhje të dyfishtë të vozitjes rrugore dhe hekurudhore të cilat vertikalisht janë tërhequr dhe kanë nxjerr pavarësisht nga ajo nëse gjysmë-rimorkio transportohen në rrugë ose në hekurudhë. Këto shasi e zvogëlojnë bartësin e gjysmë-rimorkiove rrugore-hekurudhore.

Teknologjia e dytë bimodale ishte e njohur nën emrin Tiger Rail – Trailer Trail dhe është zhvilluar në Britaninë e Madhe. Gjysmë-rimorkiot rrugore-hekurudhore të anëve të poshtme ballore kanë mekanizma përkatëse për përforcimin e shasive hekurudhore të veçanta dy boshtore të cilat janë të pavarura nga gjysmë-rimorkiot kur transportohen në rrugë.

Të gjitha modelet e gjysmë-rimorkiove rrugore kanë ndërlidhje tre boshtore të rrotave. Ekzistojnë dy lloje, përkatësisht modelet e shasive hekurudhore dy boshtore: shasitë hekurudhore fillestare dhe përfundimtare të cilat janë të pajisura me parakolp dhe aparate për ndërlidhjen e ndër shasive hekurudhore që përdoren për ndërlidhjen e dy gjysmë-rimorkiove (përkatësisht pjesa e pasme e pjesës së parë dhe të pasme në gjysmë-rimorkion e fundit) me përforcues të veçantë. Teknologjia e tretë bimodale e transportit është e ngjashme me dy teknologjitë e mëhershme bimodale, vetëm dallojnë në vend të gjysmë-rimorkiove speciale rrugore përdoren gjysmë-rimorkio kontejnerë. Kjo teknologji përveç se në ShBA aplikohet edhe në Australi dhe në vendet e tjera të zhvilluara.

VII.2. Procedurat për formimin e kompozitit Bimodal sipas sistemit „MARK V ROAD RAILER”

1. Tërheqësi me gjysmë-rimorkion speciale rrugore me drejtim nga mbrapa afrohet deri te shasitë hekurudhore dy boshtore e ashtuquajtur „bogie-pauk”).




2. Pjesa e pasme nga gjysmë-rimorkio rrugor vertikalisht ngrihet me ndihmën e ndërlihdësit hidraulik personal me presion nga mjeti tërheqës, ndërsa shasitë hekurudhore dy boshtore që gjendet në rrugën hekurudhore hyn (tërhiqet ose shtyn) nën pjesën e varur të gjysmë-rimorkios.



3. Me ngritjen hidraulike të rrotave të gjysmë-rimorkios, automatikisht lëshohet në shasitë hekurudhore dy boshtore me të cilat përforcohet automatikisht.



4. Me ngritjen e mbështetësit të gjysmë-rimorkios rrugore vertikalisht ngrihet fundi i tij përpara, kështu që gjysmë-rimorkio mund të ndahet nga mjeti tërheqës.




5. Tërheqësi, përkatësisht mjete tërheqës ndahet nga gjysmë-rimorkio rrugor që mbetet në rrugën hekurudhore.



6. Shasitë hekurudhore dy boshtore shtypet (tërhiqet ose shtyhet) në rrugën hekurudhore kah pjesa e përparme e gjysmë-rimorkios rrugore.



7. Me ngritjen e mbështetësit të pjesës së përparme, gjysmë-rimorkio rrugor lëshohet në shasitë hekurudhore dy boshtore dhe me këtë gjysmë-rimorkio rrugor fton dukje të vagonit të ngarkuar hekurudhor.



Me këtë mënyrë mundësohet transformimi, përkatësisht transportimi nga automjetet rrugore ngarkuese në vagonët ngarkues hekurudhor me ndihmën e terminaleve të thjeshta hekurudhore, pa infrastrukturë të veçantë rrugore-hekurudhore dhe superstrukturë rrugore-hekurudhore.

KAPITULLI VIII

VIII. MUNDËSIA E APLIKIMIT TË TEKNOLOGJIS HUCK-PACK NË VENDIN TONË

Sistemi hekurudhor ekzistues në Republikën e Kosovës është relativisht i vjetër dhe nuk përputhet me standardet Evropiane. Për zhvillimin e shtetit të ri të Kosovës dhe për aderimin sa më të shpejte të tij në Bashkimin Europian, veç të tjerash duhet edhe një infrastrukturë e transportit më e përparuar. Ndër infrastrukturat e transportit, transporti hekurudhor është ai me efikasitet për arsye:

- leverdisë ekonomike,
- lidhjes së Kosovës me Europën dhe Azinë,
- mbrojtjes së mjedisit pasi është një transport që shkakton minimumin e ndotjes.

Për të dhënë sado pak kontributin tonë në zgjidhjen e këtij problemi të rëndësishëm ekonomik, në ndërmorëm këtë studim dhe kërkim shkencor të parë në tre aspekte:

1. Argumentimi nga ana shkencore e praktike, pse është e domosdoshme të modernizohet ky lloj transporti,
2. Si mund të modernizohet ky lloj transporti me ndërhyrjet e ndryshme në të gjithë elementët e rrjetit.
3. Cilat janë problemet tekniko-ekonomike dhe menaxheriale të modernizimit të rrjetit hekurudhor të Kosovës.



Fig.8.1.Gjendja ekzistuese e hekurudhave në vendinë tonë.

VIII.1. Rrjeti hekurudhor në Kosovën e ish Jugosllavisë

Në kuadër të kornizës së rrjetit të ish-hekurudhave Jugosllave, Korridori X ka lidhur Beogradin përmes Lapovos dhe Nishit me Shkupin. Vija hekurudhore magjistrale është e degëzuar në Lapovo që gjendet mes Beogradit dhe Nishit dhe është formuar një rrugë tjetër për në Shkup, kjo e fundit vazhdon në relacion me Beograd-Lapovo-Kralevë-Fushë Kosovë-Shkup. Shpejtësia e paraparë përgjatë vijës hekurudhore magjistrale ishte 100-120 km/h në mes të Mitrovicës dhe Gurezës, ku në këtë pjesë vija shtrihej në një luginë të gjerë pa kthesa dhe pa pjerrësi të konsiderueshme.

Sistemet sinjalizuese të instaluar janë projektuar dhe përgatitur që të funksionojnë edhe për rrjetin e elektrifikuar të vijës hekurudhore Leshak-Hani i Elezit në vitet 80-të. Në vitet 80-të, elektrifikimi i mundshëm i vijës magjistrale hekurudhore është studiuar por nuk është implementuar kurrë, kështu që vija ka mbetur e paeletrifikuar. Në atë periudhë, vija hekurudhore magjistrale më së shumti u ka shërbyer minierave dhe industrisë së rëndë metalike në mes të Fushë Kosovës dhe Kralevës. Gjithashtu është përdorur për trenat transit nëpër Kosovë nga shtetet e Evropës perëndimore, deri në Shkup dhe më tutje në Greqi. Në vitet e fundit, hekurudhat e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë kanë riparuar gradualisht dëmet e luftës dhe kanë rifilluar një funksionim të kufizuar për pasagjerë dhe po ashtu edhe një numër i vogël i transporteve të mallrave, kjo si pasojë e dëmtimit të industrisë së rëndë gjatë luftës. Hulumtimi i këtij punimi shkencor duhet të arrijë objektivat, si për ngarkesa transportim mallrash ashtu edhe për transport të udhëtarëve dhe ka për qëllim:

- Të sigurojë qasje të besueshme për konsumatorët e shërbimeve hekurudhore me disponueshmëri relativisht të lartë të kapacitetit të infrastrukturës. Për të siguruar cilësi të caktuar të komponentëve të sinjalizimit dhe,
- Telekomunikacionit të infrastrukturës hekurudhore për lehtësimin e veprimeve përgjatë vijës në përputhje me standardet bashkëkohore Europiane. Për të eliminuar bllokimin fizik për operacionet e rregullta dhe të sigurta,
- Hekurudhore përfshirë këtu edhe objektet bashkëkohore për transportim si RoLa, kontejnerët e Lartë-kubik, etj.
- Të sigurojë nivel më të lartë të shërbimeve standardet për modernizimin dhe përmirësimin e vijës deri në 16km/h, duke përfshirë elektrifikimin.
- Të eliminohen pengesat qarkulluese në pjesën moçalore të linjës hekurudhore.
-

VIII.2. Analiza e gjëndjes ekzistuese të infrastrukturës

Hekurudhat e Kosovës operojnë në më shumë se 330 km të linjave me binarë të njëfishtë të pa elektrifikuar. Edhe pse pozita gjeografike dhe gjeometria e shumë pjesëve të rrjetit do të lejonte shpejtësinë 160 km/h, kufizimi i shpejtësisë maksimale është 70 km/h. Pajisja e sinjalizimit dhe telekomunikimit është në procese të modernizimit; vendkalimet hekurudhë rrugë nuk janë të pajisura me barriera automatike apo edhe janë zëvendësuar me ura rrugore. Linja hekurudhore magjistrale ka përjetuar shkallën më të lartë të dëmeve në periudhën e viteve 1990-2002.

Deri më tani, këto dëme janë riparuar pjesërisht. Niveli i infrastrukturës së rregullt dhe mirëmbajtjes bazë në atë periudhë ishte reduktuar në minimum duke rezultuar në kushte nën standard të linjës, ku shpejtësia maksimale reduktohej në 60-70km/h përgjatë gjithë linjave.



Fig.8.2. Transporti hekurudhor

Trendi i zhvillimi pozitiv u ndërpre disi në vitin 2008 nga kriza globale financiare. Hekurudhat për transportin ndërkombëtar të mallrave përfshin importin e produkteve të:

- naftës nëpërmjet Shkupit,
- importin e materialeve për Ferronikelin,
- importin e përgjithshëm nga jugu,
- transportet e nevojshme për trupat ushtarake të NATOS/KFOR-it,
- transporti i kontejnerëve në mes të terminalit hekurudhor në Miradi dhe portin e Selanikut.



Fig.8.3. Stacioni hekurudhor në Fush Kosovë.



Fig. 8.4. rrjeti hekurudhore në Kosovë.

VIII.2.1. Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore

Infrastruktura hekurudhore në Kosovë sot është e vjetruar dhe nuk është në gjendje t'i përmbushë nevojat e udhëtarëve dhe transportuesve të mallrave. Ajo nuk ofron lidhje adekuate me shtetet fqinje dhe portet e tyre. Për këtë arsye ka nevojë urgjente për modernizim dhe zhvillim në mënyrë që t'i plotësojë nevojat dhe të ofrojë shërbime të qëndrueshme të transportit.

Strategjia multimodale parasheh që hekurudhat:

- Të zbatojnë gradualisht rekomandimet e nxjerra në bazë të studimit të fizibilitetit të Linjës 10 (kryer nga Konsulenca e angazhuar dhe mbështetur nga BERZH) për të pasur, së paku, këtë linjë në gjendje të mirë për operim. Pjesa jugore e linjës 10 duhet të konsiderohet si prioritare si dhe në një ardhme të afërt duhet rishikuar mundësit e funksionalizimit të pjesës veriore të linjës X. Në bazë të studimit të fizibilitetit për modernizimin e linjës 10, është cekur:
- Të kryhen studime të fizibilitetit mbi rehabilitimin/modernizimin e linjave Lindje-Perëndim, që lidhin aeroportin me degët e pjesës jugore të linjës. për t'i shërbyer popullsisë së zonave dhe qyteteve të rëndësishme, siç janë Podujeva, Gjakova dhe Prizreni.
- Të kryhen studime të fizibilitetit për ndërtimin e linjës hekurudhore që lidhë Kosovën me Shqipërinë, me qendrat kryesore dhe portet e saj.
- Të kryhen studime të tregut për t'i kuptuar nevojat për terminale multimodale për nevojat e Kosovës dhe për ta kuptuar vendin e tyre në rrjetin e terminaleve intermodale në Ballkan dhe lidhjen e tyre me qendrat e distribucionit dhe logjistikës në rajon.

VIII.3. Zhvillimi i shërbimeve të transportit hekurudhor

Sistemi i transportit hekurudhor ka pësuar ndryshime me ndarjen e Hekurudhave të Kosovës në dy subjekte. Njëra nga to, INFRAKOS, nga 01.09.2011, është përgjegjëse për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore. Subjekti i dytë, TRAINKOS, është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave. INFRAKOS dhe TRAINKOS janë ndërmarrje publike.

Shërbimet e transportit hekurudhor për udhëtarë ekzistojnë, mirëpo mjetet e realizuara nga këto shërbime, nuk i mundësojnë një zhvillim të mirëfilltë këtij sektori e, për këtë, as ofrimin e shërbimeve cilësore brenda dhe jashtë shtetit.

Ekzistojnë vetëm katër trena në pjesën jugore të Linjës 10 nga Fushë - Kosova (jo Prishtina) për në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë, me vetëm një shërbim direkt në ditë për në Shkup. Në linjën e Pejës, operojnë vetëm dy trena në ditë.

Me tren transportohet kryesisht lënda e parë, dhe kjo në relacione të shkurtëra brenda vendit dhe, pjesërisht, nafta dhe gazi që importohet. Transporti hekurudhor i kontejnerëve nuk është i

leverdishëm, për arsye se ekziston vetëm një lidhje me Shkupin e Selanikun e, përveç kësaj, egzistojnë vështirësi me portin e Selanikut, me Kompaninë e Hekurudhave të Greqisë dhe me subjektet që janë në kuadër të OSE-së.

Për zhvillimin e transportit ndërkombëtar hekurudhor, operatori hekurudhor duhet të jetë në gjendje të ofrojë shërbime cilësore brenda dhe jashtë vendit. TRAINKOS-i nuk mund të operojë me vagonët e mallrave dhe vagonët e udhëtarëve, sepse Kosova nuk është e regjistruar si shtet në organizatat ndërkombëtare të hekurudhave e, për pasojë, nuk mund të listojë inventarin e saj hekurudhor në pajtim me rregullat ndërkombëtare. Për shërbime jashtë shtetit, TRAINKOS-i duhet të merr me qira, apo të huazojë inventarin hekurudhor të regjistruar në shtete tjera dhe të autorizuar në Kosovë, gjë që rritë shpenzimet dhe rreziqet.

TRAINKOS-i, në të ardhmen, duhet të ndërmerr masa për qasje në tregjet për projektimin, prodhimin dhe komercializimin e shërbimeve të reja të transportit, si për udhëtarë ashtu dhe për mallra, dhe kjo:

- Për udhëtarët- shërbime të reja, duke shfrytëzuar vagonë modernë, të cilët duhet të përgatiten dhe të jenë të gatshme për të hyrë në funksion menjëherë pas renovimit të infrastrukturës hekurudhore; këto shërbime duhet të definohen dhe të negociohen me autoritetet kombëtare dhe lokale
- Për bartje të ngarkesave: TRAINKOS-i, apo cilido operator tjetër i autorizuar për të vepruar në Kosovë, duhet të krijojë shërbime të reja në baza komerciale. TRAINKOS-i do duhej të përkrah zhvillimin e kompanive të reja të distribucionit dhe logjistikës, në veçanti të atyre për mallra për konsum të gjerë dhe pajisje shtëpiake, dhe t'ju ndihmojë atyre në propozimin e shërbimeve efikase dhe konkurruese të transportit.

Edhe për shërbimet për udhëtarë, edhe për shërbimet për mallra, do duhej dizajnuar kombinime të mënyrave të transportit rrugor dhe hekurudhor, për të ofruar shërbimet më efikase dhe joshëse të mundshme, por edhe për të shfrytëzuar më së miri burimet ekzistuese të të dyja mënyrave të transportit, me qëllim të shtimit të sigurisë dhe qëndrueshmërisë.

- Për shërbimet për udhëtarë: autoriteteve lokale duhet bërë me dije faktin se shërbimet me autobusë nuk konkurrojnë në mënyrë sistematike me shërbimet hekurudhore, por paraqesin shtojcë të shërbime hekurudhore për pjesët përfundimtare të rrugëtimit, duke ofruar lidhje të koordinuara dhe të organizuara transporti.
- Për shërbime të transportit të mallrave: janë bizneset dhe njësitë afariste, operatorët intermodalë, transportuesit e ngarkesave dhe kompanitë e logjistikës ato që propozojnë shërbimet përkatëse duke u bazuar në kombinimin më të mirë të mënyrave të transportit dhe duke marrë parasysh cilësinë, besueshmërinë dhe efikasitetin ekonomik të tyre.

VIII.4. Propozimi

Është theksuar se transporti hekurudhorë në Kosovë nuk është funksional për transportin e kontenerëve dhe ngarkesave të rimorikëve, me fjale të tjera nuk është funksionale teknologjia e avansuar Huck-Pack, problemi kryesor qëndron në gjendjen ekzistuese, përkatësisht në mungesën e infrastrukturës hekurudhore që lidh Kosovën me shtetet fqinje, Shqipërinë dhe Malin e Zi, por edhe me Bullgarinë dhe Turqinë. Kjo çështje është me prioritet, duke marrë parasysh trendet e reja në rritje të transportit të mallrave dhe pasagjerëve në dhe nga këto shtete.

Për avansimin e kësaj teknologjie në vendinë tone duhet që të investohet në mjetet hekurudhore duke marrur parasysh se në shtetet të tjera zhvillimi ekonomik është pikrishtë transporti përmes hekurudhave.

Transporti Huck-pack përfaqëson një lidhje efektive dhe racionale në mes të rrugës dhe të trafikut hekurudhor dhe siguron një transport të kombinuar të mallrave "derë më derë", të sigurt, të shpejtë dhe racionale.

Bazuar në përvojën e transportuesve rrugore një nga avantazhet është zvogëlimi i shpenzimeve për shoferët dhe udhëtarët deri në 30% të kostove totale operative të kompanive rrugore.

Në mënyrë që të përcaktoj avantazhet dhe disavantazhet e secilës teknologji huckepack individualisht, me një argumentim më të madh dhe të besueshëm të sigurisë mund të jetë bërë që teknologjia transportuese me platformë C ka përparësi të përgjithshme në krahasim me transportin me platformë teknologjike A dhe B, pastaj transporti me platformë teknologji B ka përparësi të përgjithshme në krahasim me transportin me platformë teknologji A. Këto pretendime janë të bazuara shkencërisht në rezultatet e kërkimit të aplikuar dhe përvojat e përdoruesve dhe ofruesve të shërbimeve në komunikacionin transporti me platformë gjermane.

Sipas kësaj teknologjie ngarkimi i kamionëve me rimorkio ose kokës tërheqës me gjysmë rimorkio të ngarkuar me ngarkesë, në vagonët e hekurudhës me dysheme të lëshuar poshtë.

Teknologjia Huck-pack



Fig.4.1. Kamionet që shkaktjnë kolona të mëdha rrugëve ku perdoret edhe për qëllime të tjera.



Fig. 4.2. Vëndosja e automjeteve transportuese në vagonat e trenit.

VIII.5. Rekomandimi

1. Rekomadojmë që qeveria e Kosovës të ngrëjë grupet e duhura të specialistëve për të hartuar projektet e rrjetit të rinovuar hekurudhor sipas fazave, sipas segmenteve të vecanta dhe sipas normativave europiane.
2. Me projektet e gatëshme dhe të konsultuara me specialiste të institucioneve të huaja qeveria të planifikojë një pjesë të fondeve për realizimin e projekteve, në buxhetin e Kosovës, dhe për pjesën tjetër të kërkojë fonde nga institucione ndërkombëtare financiare dhe nga bashkimi European.
3. Meqënëse hekurudha është një mjet ideal për qarkullimin e njerëzve dhe të mallrave mendojmë se duhen bërë të njëjtat projekte dhe nga qeveria e shqipërisë për rrjetin e saj hekurudhor i cili është pothuajse totalisht i shkatërruar. Kjo do të ishte një mënyrë që rrjeti hekurudhor të lidhi të gjitha trevat shqipfolëse duke forcuar kështu kombin tonë.

IX. PËRFUNDIMI

Në këtë punim të diplomës është treguar rëndësia e teknologjisë së transportit, roli i saj dhe ndikimi i saj në zhvillimin e teknologjisë për shfrytëzim në komunikacionit. Në trajtimin e kësaj teme si qëllim kryesor është analizuar teknologjit të ndryshme gjatë aplikimit të transportit sa me moderne që janë të shfaqura gjatë prezantimit të temes si në terësi.

Përmes këtij punimi është treguar roli dhe rëndësia e teknologjisë Huckpack dhe nënsistemeve të teknologjisë Huckpack. Pikë e rëndësishme e këtij punimi është se zhvillim i këtyre sferave të jetës shoqërore të gjithë njerëzve gjithnjë e më shumë i drejtohet shfrytëzimit efkas dhe efektiv të resurseve të kufzuara, qoftë materiale ose financiare. Për t'i shfrytëzuar maksimalisht degët e transportit ashtu që të jenë efkase dhe efektive, është e nevojshme të njëjtat të kombinohen, d.m.th., për të shfrytëzuar anët pozitive të llojeve individuale të transportit, dhe ato negative të zvogëlohen.

Pas analizës së bërë, për vendinë tone për një teknologji siq është huck-pack na del se vendi jonë nuk i përmbush kriteret e nevojshme për realizimin e kësaj teknologjie gjë që duhet të investohet në hekurudhat e e Kosovës për një transport sa më të sigurt me sa me pak shpenzime dhe për një ambient sa më të pastër.

X. LITERATURA

- [1]. *Prof. Dr. Musli Bajraktari* – Teknologjia e Transportit, *Prishtinë 2015*,
- [2]. *Prof. Dr.ass. Shpetim Lajqi* – Sistemet Integrale dhe Intermodale, *Prishtinë 2014*,
- [3]. *Docent. Dr. Cventanovski Ile* – Teknologjitë Bashkëkohore të transportit, *2009*,
- [4]. EUROPEAN COMMISSION, DIRECTORATE - GENERAL FOR ENERGY AND TRANSPORT, *Europeam Best Practice Guidelines on Cargo Securing for Road Transport, Luxembourg 2012*

Ueb faqe:

- [1]. www.modalohe.com
- [2]. www.hupac.ch
- [3]. <https://www.google.com/webhp?sourceid=chrome-instant&ion=1&espy=2&ie=UTF-8#q=huckepack%20technology>
- [4]. <http://www.samskip.com/who-we-are/equipment/trucks--trailers/>